



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-028  
Prishtinë, më 22 korrik 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 22 KORRIK 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Nexhat Daci, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Zylfi Merxha dhe Bojan Stojanovq, ndërsa mungoi Ibrahim Makolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Rinor Bekaj dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai i propozoi edhe dy pika shtesë.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 korrik 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

#### **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 korrik 2008**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 16 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

**Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, nga radha e Grupit Parlamentar të AKR-së, kërkoi që kërkesa e këtij grupi për ta ftuar në interpelancë ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, e cila është konstatuar saktësisht në procesverbal, të shtyhet për seancën e parë të radhës të sesionit vjeshtor.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të propozuar, veç e veç.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, konfirmoi rendin e ditës për seancën plenare të caktuar më herët për dt. **29 korrik 2008**, duke ia shtuar edhe dy pika të tjera. Kryesia vendosi që Kuvendit t'ia propozojë këtë

#### **R e n d d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 15 korrik 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Organit të pavarur përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes,
9. Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të Kuvendit për procedimin e ligjeve të shpallura në rishqyrtim në komisionet parlamentare.

Shqyrtimi i dytë të Projektligjit për ndërmjetësim, Shqyrtimi i Raportit të RTK-së për vitin 2007, Raporti i KPM-së për vitin 2007, Programi i Qeverisë për barazi gjinore, Rekomandimi i Komisionit të Bujqësisë dhe Mjedisit lidhur me gjendjen në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe në fshatin turistik në Prevallë, Rekomandimi i Komisionit të Shërbimeve Publike dhe Administratë Lokale për formimin e Komisionit Ad hoc, **u shtyn për seancën e parë të radhës të sesionit vjeshtor** të Kuvendit.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

- 3.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për rritjen e pagave për personelin e kësaj zyreje.

Kryesia, mbështeti rekomandimin Komisionit për Buxhet dhe Financa që rritja e pagave për personelin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të shqyrtohet me rastin e propozimit të projektbuxhetit për vitin 2009.

- 3.2 Shqyrtimi i ofertës së “Kosovapress”-it

**Sekretari** i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i informoi anëtarët e Kryesisë lidhur me ofertën e “Kosovapress”-it për parapagimin e lajmeve, publikimin e shpalljeve, të konkurseve dhe të tenderëve.

**Kryesia**, pasi u informua me ofertën e “Kosovapress”-it, konstatoi se ofertat e çdo agjencie duhet të trajtohen në përputhje me Ligjin për prokurimin publik.

- 3.3 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Radmila Vujoviq

**Slobodan Petroviq** e arsyetoi kërkesën e deputetes Radmila Vujoviq, e cila në kohën kur janë formuar grupet parlamentare nuk kishte qenë anëtare e Grupit Parlamentar të SLS-së. Kuvendi ka ndarë mjete të veçanta për financimin e partive politike, të përfaqësuara në Kuvend sipas numrit të deputetëve dhe një pjesë e mjeteve nga ajo shumë u ndahen grupeve parlamentare. Ndërkohë, deputetja Radmila Vujoviq i është bashkangjitur Grupit Parlamentar të SLS-së. Mbi këtë bazë, ai kërkoi nga Kryesia që të marrë vendim për rindarjen e mjeteve për deputetët që e përfaqësojnë komunitetin serb në Kuvend.

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë

## V E N D I M

Nga shuma e mjeteve të ndara për partitë politike të përfaqësuara në Kuvend sipas numrit të deputetëve dhe për grupet parlamentare, për deputeten Radmila Vujoviq të barten mjetet në fondin e Grupit Parlamentar SLS.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së shefit të Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit për lejimin e udhëtimit Zyrtar në SHBA

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

**V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Kabinetit të Kryetarit në SHBA, prej 22 gushtit deri më 5 shtator 2008, në këtë përbërje: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Mehmet Hajrizi e Ismet Hajrullahu, këshilltarë të Kryetarit, Skender Reçica , shef i Protokollit dhe Elton Tota, përkthyes.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për anëtarët e Delegacionit nga paragrafi një (1) i këtij vendimi, të specifikuara në kërkesë, paguhet nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.5 Shqyrtimi i Raportit të sekretarit të Kuvendit dhe të shkresës së punëkryesit “Mega” lidhur me ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi

**Kryetari** i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Komisioni, i formuar nga ana e Kryesisë për të shqyrtuar çështjen e ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, ka pasur takime me punëkryerësin, mbikëqyrësin dhe projektuesin e saj.

Punëkryerësi ka pasur një vërejtje për raportin që është bërë më parë, nga një Kompani e pavarur, lidhur me vlerësimin e investimeve në atë objekt.

Ndërkohë, kemi biseduar me Presidentin dhe Kryeministrin që edhe ata të përfshihen në përfundimin e punimeve në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi, në mënyrë që ajo të jetë pronë e përbashkët e institucioneve shtetërore dhe të menaxhohet nga një Departament i veçantë për të.

Kemi ardhur në përfundim që në punën e Komisionit të përfshihen edhe disa ekspertë nga Universiteti i Prishtinës, të fushës së ndërtimitarisë, punëkryerësi, mbikëqyrësi dhe një jurist jashtë Kuvendit për të vlerësuar gjendjen reale të investimeve në atë objekt dhe të bëhet një prerje.

Pasi të bëhet një prerje, të hartohet një raport për Kuvendin dhe të shihen mundësitë për vazhdimin e punimeve në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi apo vazhdimi i punimeve t’i kalohet në përgjegjësi Ministrisë së Shërbimeve Publike, e cila edhe është përgjegjëse për akomodimin e institucioneve dhe menaxhimin e objekteve të institucioneve shtetërore.

**Kryesuesi** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**